



*LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards*

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE**  
**I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**  
**RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË NGARKIMIT TË NAFTËS**  
**BRUTO DHE LINJËS HEKURUDHORE NË FIER**

**Porositës:**

**ALBRAIL sh.p.k**

**Përgatiti**

**ABKONS shp.k**

**Qershor, 2017**

Kompania:	ABKons
Titulli i Dokumentit:	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

**Emri i raportit:**

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË NGARKIMIT TË NAFTS BRUTO DHE LINJËS HEKURUDHORE NË FIER

Pergatit nga:

Inxhinjer Halit Kamberi

Ekspert Kombëtar për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor

ABKONS.shp.k.



Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

## 1. Përmbajtje

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>6</b>
1.1 Përshkrim i përmbledhur i projektit.....	6
1.2 Zonat alternative .....	9
1.2.1 Përshkrimi i vendndodhjes .....	10
<b>2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E STUDIMIT TË VNM .....</b>	<b>12</b>
2.1 Interpretimi ligjor dhe kërkesat ligjore mbi projektin e propozuar .....	12
2.2 Leja Mjedisore .....	12
<b>3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....</b>	<b>13</b>
3.1 Përmbledhje e projektit të propozuar .....	13
<b>4. ALTERNATIVE PROJEKTIT .....</b>	<b>19</b>
4.1 Avantazhet e bërjes së projektit.....	19
4.2 Avantazhet e zonës së përzgjedhur për stacionin e transferimit .....	20
<b>5. PËRSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT .....</b>	<b>21</b>
5.1 Vendndodhja e zones dhe mjedisi rrethues.....	21
5.2 Toka .....	22
5.3 Zonat e nxehta mjedisore .....	24
<b>6. IMPAKTET POTENCIALE TË PROPOZIMIT DHE MASAT ZBUTËSE .....</b>	<b>25</b>
6.1 Hyrje .....	25
6.2 Përmbledhje e ndikimeve potenciale mjedisore .....	26
6.3 Ndikimet Potenciale dhe masat zbutëse.....	28
6.3.1 Ndikimet në Cilësinë e Ajrit .....	28
6.3.2 Ndikimet e Zhurmave .....	29
6.3.3 Ndikimet në tokë .....	30
6.3.4 Ndikimet ne ujë (sipërfaqësore dhe nëntokësorë) .....	31
6.3.5 Ndikimet nga mbetjet .....	31
6.3.6 Ndikimi në biodiversitet .....	32
6.3.7 Shëndeti dhe siguria në punë dhe në komunitet .....	32
6.3.8 Ndikimet mbi popullsinë lokale.....	33
<b>7. PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR.....</b>	<b>34</b>
Aneksi 1: Planimetria e stacionit të ngarkimit të naftes bruto dhe linjës hekurudhore sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE ( Pulkovo 1942 Gauss Kruger Zona 4N) .....	38
Aneksi 2: Foto nga vendi i projektit dhe zona përreth.....	43

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

## Shpjegimi I shkurtimeve

VNM	Vlerësimi i ndikimeve në mjedis
AMP	Agjencia e mjedisit dhe pyjeve
ARM	Agjencia rajonale e mjedisit
AMM	Agjencia e mbrojtjes së mjedisit
SN	Stacioni i ngarkimit
H1	Zona e stacionit të ngarkimit
IKM	Inspektorati kombëtar mjedisor
IRM	Inspektorati rajonal mjedisor
IUCN	Unioni ndërkombëtar për ruajtjen e natyrës
LMM	Ligji për mbrojtjen e mjedisit
MeSH	Ministria e shëndetësisë
MM	Ministria e mjedisit
MZHUT	Ministria e zhvillimit urban dhe turizmit
NJKP	Njësia e koordinimit të projektit
PMM	Plan i menaxhimit mjedisor
SN	Stacioni i ngarkimit të naftës
SHSP	Shëndeti dhe siguria në punë
SHBSH	Shëbimi gjeologjik shqiptar
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis

## Lista e figurave

Figure 1: Planimetria e ndërtimit të stacionit të ngarkimit të naftës bruto (Km 87+600) .....	8
Figure 2: Vendodhja e stacionit të ngarkimit të naftës bruto dhe linja hekurudhore (Km 85+625 – Km 87+700) .....	9
Figure 3: Harta topografike e stacionit të ngarkimit të naftës bruto dhe linja hekurudhore .....	11
Figure 4: Zona e ish stacionit të ngarkimit të naftës bruto dhe ish linjat hekurudhore .....	14
Figure 5: Linjat hekurudhore që dalin nga stacioni i mallrave Fier .....	15
Figure 6: Projektimi i rritjes së prodhimit ditor në m <sup>3</sup> .....	16
Figure 7: Platforma e ngarkimit .....	17
Figure 8: Pamje nga instalimet ekzistuese të ish stacionit të ngarkimit të naftës bruto	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Figure 9: Përdorimi i tokës pranë zonës së projektit .....	22

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTAES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

Figure 10: Zonimi Gjeoteknik (burimi SHBSH)..... 24  
Figure 11: Harta administrative e Bashkisë Fier ..... **Error! Bookmark not defined.**

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

## 1. HYRJE

### 1.1 Përshkrim i përmbledhur i projektit

Kompania Albrail sh.p.k. pasi ka fituar kontraktin e PPP me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës për rikonstruksionin, operimin dhe transferimin (ROT) pas 25 vitesh të linjave hekurudhore Fier-Vlorë dhe Fier-Ballsh, kërkon të projektojë dhe ndërtojë stacionin e ngarkimit të vagonave çisternë me naftë bruto në ish-stacionin e vjetër të Rafinerisë Fier. Projekti "Rehabilitimi i Infrastruktures Hekurudhore prane Rafinerise, Fier" ka ne perberje komponentet ne vijim:

- Komponenti A: Infrastruktura, ndertimin e stacionit të ngarkimit të naftës bruto dhe dy linjave paralele, ku ne secilin krahe do te ndodhen 8 vagonë çisternë;
- Komponenti B: Rehabilitimi i mjedisit;
- Komponenti C: Pastrimi i Zonës së Ndotur;
- Komponenti D: Menaxhimi dhe Monitorimi i Projektit.

Qëllimi i projektit të ndërtimit të terminalit të ngarkimit të naftës bruto dhe rehabilitimin e linjës hekurudhore mbi degëzimin hekurudhor të rafinerisë Fier nga ana e shoqërisë koncesionare Albrail sh.p.k. është transportimi i naftës bruto në rrugë hekurudhore duke zëvendësuar transportin aktual rrugor. Fatmirësisht pozicioni në të cilën do të ndërtohet terminali hekurudhor gjendet shumë afër terminalit të Bankers Petroleum Ltd, gjë që mundëson lidhjen e dy terminaleve në një kohë të shpejtë dhe me pak shpenzime. Terminali hekurudhor do të jetë pjesë integrale e infrastrukturës hekurudhore në zonën koncesionare, e cila synon të ofrojë 3-4 trena mallrash drejt Vlorës në ditë për të transportuar sasinë ditore të naftës bruto dedikuar për eksport, duke larguar prezencën ditore të 80-100 autoboteve nga autostrada Fier-Vlorë.

Në varësi të aktivitetit të rafinerisë së Ballshit, terminali i ngarkimit të naftës bruto mbi infrastrukturën hekurudhore, paraqet një mundësi më shumë për transportin e naftës bruto me tren drejt Ballshit duke qënë se linja hekurudhore Fier-Ballsh është pjesë e zonës koncesionare.

Përveç zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore, ky projekt do të ofrojë dhe avantazhet e mëposhtme:

- Transporti hekurudhor është më i shpejtë, i besueshëm dhe shumë më pak i ndikuar nga kushtet e motit dhe bllokimet e trafikut;
- Hekurudha mund të transportojë volume më të mëdha mallrash për distanca të ndryshme, duke e bërë atë transportin më ekonomik, më të shpejtë dhe të vlefshëm pavarësisht natyrës së mallrave. Për më tepër hekurudha është elastike sa i përket kapacitetit, i cili mund të rritet lehtësisht duke shtuar numrin e vagonëve;

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

- Ky është transporti më i mirëorganizuar sesa çdo lloj tjetër transporti. Ai ka lëvizje dhe orare të përcaktuara. Shërbimi i tij është më i sigurtë, I pandryshueshëm dhe i rregullt krahasuar me transportet e tjerë;
- Për shkak se mundësitë për aksidente dhe rrëzime në transportin hekurudhor janë minimale krahasuar me transportet e tjerë, ai quhet transporti më i sigurtë midis të tjerëve;
- Transporti hekurudhor konsumon më pak energji për vënien në punë të mjeteve motorike krahasuar me transportet e tjera konkurruese;
- Rritja e volumit të mallrave të transportit hekurudhor zvogëlon koston e mirëmbajtjes së rrugëve automobilistike;
- Rritja e transportit hekurudhor ndikon në uljen e nivelit të gazrave të dëmshëm dhe grimcave të pluhurit që clirohen nga mjetet e transportit rrugor, duke mbrojtur mjedisin.

Stacioni i ngarkimit do të shërbejë për transportin e naftës bruto, realizuar kjo me ane të ndertimit të dy linjave paralele, ku në secilin krahe do të ndodhen 8 vagonë çisternëe dhe vendi i stacionit të ngarkimit të naftes bruto, me kështu efektive. Stacioni i ngarkimit do të funksionojë si zonë furnizuese nga depozita eksistuese me hidrokarbure dhe do të shpërndahet në katër tubacione të vegjël, të cilët do të ngarkojnë njëkohësisht 4 vagonë çisternëe. Stacioni i ngarkimit të naftës është projektuar për një volum ditor maksimal prej rreth 7100m<sup>3</sup>/ditë. Në këtë stacion nuk do të ketë depozita dhe produkti do të vijë me tubacion nga depozita e naftes bruto të Bankers Petroleum, të ndertuara pranë murit rrethues të rafinerisë Fier dhe do të shpërndahet në katër tubacione me të vegjël të cilët do të ngarkojnë njëkohësisht 4 vagonë çisternëe.

Në Komponentin B, Projekti përfshin rehabilitimin e mjedisit përtej mureve të rafinerisë, të cilat janë në një distancë të afërt me objektet e banimit. Infrastruktura ekzistuese hekurudhore, në të cilën do të kryhet transporti i naftes bruto, ndodhet në afërsi të objekteve të banimit, duke shërbyer në përmirësimin e rrugëve të aksesit, monitorimit të shkarkimeve të ujerave të zeza, monitorimit të eriozionit dhe mos respektimit të normave të shkarkimit të lendeve të ngurta e të lengeta industriale.

Në bazë të Ligjit, Nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar, përcaktojmë dhe kategorinë e hidrokarburit që do të transportohet, me qëllim paraqitjen e rrezikshmeri të hidrokarburit si dhe sasinë maksimale të depozituar në vagonat çistern. Kategoria e hidrokarburit<sup>1</sup>

- Petroleum crude oil – UN1267

<sup>1</sup>Sipas kodifikimeve ndërkombëtare të pranuar, dhe rezulateve të testit të naftes bruto të realizuar nga SGS në dhjetor 2015

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

- Class – 3
- Packing group – PG II
- Crude oil flash point ASTM D 93 / 32~33 °C
- Hidrokarburi rezulton i kategorisë së I-re.

Zona e propozuar për ndërtimin e stacionit tëri të ngarkimit të naftës ndodhet ne brendësi te zonës industriale se Azotikut, në vendin e ish-stacionit i ngarkimit të vagonave çisternë në Rafinerinë e Fierit, pozicionuar në pjesën veri-perëndimore të Rafinerisë. Ky stacion lidhet me hekurudhën në stacionin e mallrave Fier, me një linjë hekurudhore që shtrihet për 2.5km dhe ndahet në tre degë. Me një sipërfaqe prej rreth 60 ha, zone industriale përfshin gjithashtu Parkun Industrial të Prodhimit të Azotit, zonën e Rafinerisë së Naftës, si dhe ish-TEC-in. Zona e Rafinerise së Naftës ndodhet rreth 3km nga qyteti i Fierit dhe 6 km nga autostrada Fier-Levan.




Figure 1: Planimetria e ndërtimit të stacionit të ngarkimit të naftës bruto (Km 87+600)



Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER




Figure 2: Vendodhja e stacionit të ngarkimit të naftës bruto dhe linja hekurudhore (Km 85+625 – Km 87+700)

## 1.2 Zonat alternative

Vend i propozuar për projektin i përket zonës së ish stacionit të ngarkimit të naftës si dhe infrastruktura ekzistuese hekurudhore që gjendet pranë zones se Rafinerise se Naftes.Vendndodhjae projektit është perzgjedhur bazuar ne kriteret krahasuese pershire ato mjedisore, gjeologjike, të pronësisë së tokës, ndjeshmërisë, popullsisë, qëndrimeve publike, infrastrukturës, menaxhimit, preferencave institucionale dhe te publikut.Alternativa me e pershtatshme per ndërtimin e rehabilitimin e infrastrukturës hekurudhore është ne zonen e Azotikut, ne zonen e Rafinerise se Naftes.

Sic u permend edhe me siper ky projekt do te nder marre masa mjedisore rehabilituese dhe per objektet e banimit ne afersi te kesaj zone, te cilet jane te prekur nga objektet industriale.

Zona e re e perzgjedhur alternativave ka avantazhe, sepse: (i) është ne afersi te infrastrukturës hekurudhore ekzistuese, ne afersi te Zones se Rafinerise se Naftes per te pasur me te lehte transportimin e produktit qe do te vijë me tubacion nga depozita e naftes bruto te Bankers Petroleum te ndertuara prane

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

murit rrethues te rafinerise Fier dhe do te shperndahet ne kater tubacione me te vegjel te cilet do te ngarkojne njekohesisht 4 vagone çisternëe; (ii) levizja e kamioneve per transportin e hidrokarbureve ne rrugen kryesore do te limitohet, (iii) shqetesimi per ujrat nentokesore, floren dhe faunen, aktivitetet bujqesore do te jete me i vogel, (iv) nuk ka plane te parashikuara, as afatgjata, per zhvillimin e zonave te shqyrtuara (konkretisht, infrastrukture turistike, industri, bujqesi, park apo peisazh i rendesise se veçante).

### 1.2.1 Përshkrimi i vendndodhjes

Zona e propozuar per rehabilitim e infrastruktures hekurudhore, ndodhet në lartësinë 30m ne nje zone fushore, rreth 3km nga qyteti i Fierit dhe 4 km nga autostrada Fier-Levan. Zona qe ne kemi marre ne studim i perket terreneve relativisht te qendrueshme: zona me përbërje shkëmbore konglomeratikë, efuzivë sedimentarë, zona me shkëmbinj rreshporë, shkëmbinj evaporitë dhe molasa të konglomerateve ranore. Bazuar ne klasifikimin e realizuar sipas relievit zona i perket:Njesise morfologjike kodrinore, qe kane kuota nga 10 m.n.d. deri në 700 m.n.d. Shpatet e kodrave e kodrinave të kësaj njësie morfologjike kanë pjerrësi nga 5 deri në 350 dhe drejtime rënie të ndryshueshme.

Kjo njësi morfologjike e prekur së tepërmi nga erozioni dhe fenomene shpati të tipit rrëshqitje të dherave dhe të shkëmbinjve. Karakteristike e kesaj zone jane tokat e kripura, qe kane origjine detare dhe jane te perhapura be fushat bregdetare te pjesë perendimore te Shqiperise (fusha e Honxhares). Ne këtë zone bimet nuk arrijne te rriten shume pasi akumulojne pak lende organike, prandaj nuk luane nje rol te redeshem ne shpejtimin e procesit toke-formues dhe ne permiresimin e cilesive fizike te tokes.Shkëmbinjtë në këtë zonë variojne nga të shkrifët argjila, avrolite, rëra, në shkëmbinj kompaktë avrolite dhe argjilë të rrallë ranore, si dhe flish. Per sa i perket rrjetit hidrografik mbizoterues jane:Semani dhe Vojsa, kryesisht Semani.

Bimet qe kultivohen ne keto lloj toka jane: misri, gruri, pambuku dhe panxhare. Bimesia sponatane perbehet nga barera shumevjecare legumizone e graminore, bime te kultivuara, si dhe bime spontane Gremi, Telishi. Biodiversiteti në një zonë më të gjerë është iltarë, me speciet e zakonshme të bimëve dhe kafshëve.Nuk ka specie bimore që gjenden vetëm në këtë zonë apo specietë tjera që janë të mbrojtura nga listat kombëtare apo ndër kombëtare apo të përfshira në Listën e Kuqe të Shqipërisë.

Kompania: ABKons

Titulli I RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË

Dokumentit: NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER




Figure 3: Harta topografike e stacionit te ngarkimit te naftes bruto dhe linja hekurudhore

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

## 2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E STUDIMIT TË VNM

### 2.1 Interpretimi ligjor dhe kërkesat ligjore mbi projektin e propozuar

Sipas ligjit Nr.10440, datë 7.7.2011 për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, projekti klasifikohet si në përcaktimin e bërë në:

- Shtojca 1, aktivitetet që i nënshtrohen procesit të paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis, Pika 21: *"Instalimet për depozitim të naftës, prodhimeve petrokimike ose kimike, me një kapacitet prej 50 000 ose më shumë tonësh"*
- Shtojcën 2- aktivitetet që i nënshtrohen procesit të paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis si: "Pika 6. *Industria kimike (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I). c) Depozitat e produkteve të naftës, petrokimike dhe kimike"*.
- Shtojcën 2, Pika 10. *Prodhime infrastrukturore, c) Ndërtimi i mjedisve të shërbimeve hekurudhore dhe terminaleve të transportit intermodal (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I),f) Instalime tubacionesh naftë dhe gazi (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I) dhe tubacionet e transportit të gazit dyoksid karboni, me qëllim injektimin dhe ruajtjen në formacione gjeologjike nën tokë;*

**Si përfundim projekti duhet ti nënshtrohet procesit të paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**

### 2.2 Leja Mjedisore

Bazuar në Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisore" (ndryshuar me Ligjin Nr. 60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit"), sipas Shtojcës 1, kemi:

Kategoria: Industritë energjetike/ Pika 1.9" Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj:  
a. Magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një cisternë e lëvizshme, cisternë hekurudhore ose anije e ujërave të brendshme në terminal.

**Si përfundim projekti nevojitet të pajiset me leje mjedisi Tipi B.**

Procesi i aplikimit dhe marrjes së lejeve të mjedisit është përshkruar në VKM (Nr.13, datë 4.1.2013) për procedurat, përgjegjësitë dhe afatet e paisjes me leje mjedisore.

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

### 3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

#### 3.1 Përmbledhje e projektit të propozuar

##### 3.1.1 Stacioni i ngarkimit të naftës bruto

Projekti i propozuar (Stacioni i Ngarkimit të naftës bruto) është pjesë e projektit të integruar që përfshin Infrastruktura, transportin dhe ndertimin e dy linjave paralele, ku në secilin krahe do të operojnë 8 vagonë çisterne si dhe ndërthurja e komponentëve të tjere bashkëveprues, të projektit të plotë të hekurudhës.

Stacioni i ngarkimit të naftës bruto do të shërbejë për ngarkimin e naftës bruto të nxjerrë nga Bankers Petroleum në fushën naftëmbajtëse të Patos Marinzes. Zona e marre në studim ndodhet në brendësi të zonës industriale së Azotikut. Me një sipërfaqe prej rreth 60 ha, kjo zonë përfshin gjithashtu Parkun Industrial të Prodhimit të Azotit, zonën e Rafinerisë së Naftës, si dhe ish-TEC-in. Zona e Rafinerisë së Naftës ndodhet rreth 3km nga qyteti i Fierit dhe 6 km nga autostrada Fier-Levan. Rruga ekzistuese që të çon në stacionin e ngarkimit duhet që të zgjerohet, sigurohet me mbështetje dhe bankina pritëse dhe të asfaltohet. Rehabilitimi, që përfshin zgjerime të vogla të rrugës ekzistuese nuk është pjesë e këtij projekti. Në bashkë me stacionin e transferimit do të ndërtohet një rrugë e re për në ST, me gjatësi 870 m dhe gjeresi 5 m. Kjo përfshin aksin 1 (kryesori) rreth 750 m dhe rruget periferiale në zonë/rrugët e shërbimit në ST (aksi 2) rreth 120 m. Mbi bazën ekzistuese do të shtohet një shtresë me material mbushës dhe një shtresë 15 cm me gure të thatuara. Gurrorja afër mund të përdoret si burim për guret e thatuara. Rruga do të asfaltohet me një shtresë 10 cm. Pjerrësia terthore e rrugës do të jetë 2.5 %.

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER




Figure 4: Zona e ish stacionit te ngarkimit te naftes bruto dhe ish linjat hekurudhore

### 3.1.2 Lidhja e stacionit të ngarkimit me linjat hekurudhore

Ish-stacioni i ngarkimit të vagonave çisternë në Rafinerinë e Fierit është pozicionuar në pjesën veri-perëndim të Rafinerisë. Ky stacion lidhet me hekurudhën në stacionin e mallrave Fier, me një linjë hekurudhore që shtrihet për 2.5km dhe ndahet në tre degë. Degëzimi i parë ndahet pas 1.4km dhe shkon në ish-fabrikën e Uresë. Linja vazhdon dhe intersekon rrugën automobilistike Fier-Vlorë me një nënkalim në distancën prej 500m nga Rafineria Fier. Menjëherë pasi përshkron nënkalimin automobilistik në një distancë prej rreth 450m nga Rafineria linja sërisht degëzohet për në drejtimin e ish- Azotikut. Dega e tretë shkon në Rafineri.

Përgjatë gjithë gjatësisë së linjës, të tre stacionet (Ureja, Azotiku dhe Rafineria) kanë qenë ndërtuar si linja njëfishe me skartament standart 1435mm. Linja hekurudhore që del nga stacioni i mallrave Fier, në një distancë prej 280m, pasi degëzohet për në ish-fabrikën e Uresë, futet dhe përshkron një zonë të ulët dhe mocalore që mbledh ujërat e Kodrës së Koshovicës për rreth 750m deri në stacionin e Rafinerisë. Ish-stacioni i ngarkimit të rafinerisë, ka patur një gjatësi rreth 100m, ku sot janë ende të padukshme 2 platforma ngarkimi nga sipër vagonave çisternë. Linja që do të transferjë naftën nga depozita deri në pikën e

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

ngarkimit me një gjatesi rreth 150ml në baze të llogaritjeve të volumit sipas grafikut të mesipërm duhet të jetë tubacion 10”.



Figure 5: Linjat hekurudhure qe dalin nga stacioni i mallrave Fier

### 3.1.3 Përshkrimi i procesit teknologjik

Kapaciteti aktual i prodhimit të naftës bruto nga kompania BPAL është rreth 3300-3500 m<sup>3</sup>/ditë. Duke u nisur nga disa synime të kompanisë BPAL edhe nga një projeksion i prodhimit të naftës me një trend rritës prej 3% në vit, nga grafiku më poshtë shohim qe volume qe do të kërkohet të transportohet do të arrijë në vit sasinë maksimale rreth 7100m<sup>3</sup>/ditë.

Kompania: ABKons

Titulli I RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË

Dokumentit: NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER




Figure 6: Projektioni i rritjes se prodhimit ditor ne m<sup>3</sup>

Projekti merr parasysh prodhimin aktual te Bankers Petroleum, me rreth 16,000 bopd ekuivalent me 2,540 m<sup>3</sup>, piken maksimale te prodhimit te arritur dy vite me pare 20,000 bopd ekuivalent me 3,170m<sup>3</sup> dhe nje trend vjetor rrites prej 3-4%. Ne fund të kontrates koncesionare, sasia maksimale e prodhimit ditor te jete rreth 44,000 bopd ekuivalent me 7,000 m<sup>3</sup>. Keto jane sasite ditore qe do te ngarkohen ne stacionin e ngarkimit te naftes bruto ne Fier dhe do te transportohen në rrugë hekurudhore.



Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER




Figure 7: Platforma e ngarkimit

### 3.1.4 Kohezgjatja e ndertimit dhe operimit

#### Kohezgjatja e ndertimit do te jete 5-6 muaj

Kohegjatja e funksionimit te projektit per Shoqerine Koncesionare Albrail sh.p.k. eshte e lidhur me kohezgjatjen e kontrates koncesionare. Pas mbarimit te periudhes se koncensionit stacioni I ngarkimit praktikisht do te vazhdoje te funksionojë keshtu qe kohezgjatja do te jete per nje periudhe te papercaktuar.

### 3.1.5 Furnizimi me ujë

Bashkia Fier siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik nga akuiferi i Vjosës, ku rreth 11.5km në jug të qytetit janë ndërtuar ndër vite 16 pus-shpime të ujit të pijshëm, të cilat nëpërmjet pompave zhytëse pompojnë ujin për konsum publik. Zona që përfshin 16 puse-shpimi të ujit të pijshëm ndodhen në pellgun ujëmbajtës të quajtur Kafarajt.

Stacioni i ngarkimit të naftes bruto nuk ka pike te lidhjes me sistemin e shperndarjes se ujesjellesit. Ne fazen e punimeve sasia e ujit qe nevojitet do te sigurohet me një autobot të specializuar dhe I licensuar per kete qellim. Pas perfundimit të punimeve do te bëhet aplikimi per pike lidhje me rrjetin e furnizimit me uje te zones ne perputhje me kushtet teknike qe zbaton Ujesjelles Kanalizime Fier. Kjo sasi uji do te sigurohet nga lidhja me rrjetin e ujesjellesit te zones, fshati Drize, ne varesi te kapacitetin te rrjetit nen administrim te Ujesjelles Kanalizime Fier.

### 3.1.6 Shkarkimet e ujerave te zeza

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

Ujrat e zeza dhe ujrat e perdorura te cilat do te prodhohen si rezultat i proceseve te ndertimit dhe te operimit të stacionit, në mungesë të kolektoreve do te menaxhohen me anë te gropave septike dhe depuratoreve te cilet do te pastrojne deri ne 90% te tyre para se te mund te derdhen ne kanale aty prane.

### **3.1.7 Sistemi i mbledhjes së ujit të shiut**

Reshjet jashtë sheshit dhe rampave/ nivele vetë SN do te grumbullohen nga një system kanalizimesh dhe devijohen përkullim në bimësinë rrethuese dhe tokat bujqesore te kultivueshme ne afersi dhe pertej mureve te zones se Rafinerise se Naftes. Në veçanti, kanalet perimetrale do të ndërtohen përtëmbledhur ujin nga shiu me furtunë nga shpatet afer me SN. Ngapikëpamja inxhinierike kanalet e ujit të shiut do të projektohen në një prerje trapezoidale me qëllim shmangjene dhe pertëmosu trazuar mbetjet qe ndodhen ne SN.

### **3.1.8 Mbetjet**

Në fazën e punimeve të ndërtimit te gjitha materialet që largohen si rezultat i gërmimit, prishjeve apo çmontimit, do te depozitohen ne sheshe te miratuara nga Bashkia Fier. Mbetjet e ngurta urbane si kartone, amballazhe te dëmtuara, si dhe mbetjet ushqimore do te jenë ne sasi te vogel dhe do të menaxhohen në përputhje me kërkësat ligjore për menaxhimin e mbetjeve urbane. Keto mbetje do te grumbullohen të ndarë ne kontenerë të veçantë të mbetjeve dhe do te perfundojne në vendepozitimet bashkiake.

### **3.1.9 Furnizimi me energji elektrike dhe përdorimi i lendeve djegëse**

Sasia e energjiseë së kerkuar do të sigurohet me rrjetin elektrik te sistemit te shpërndarjes se OSSH me fuqi te instaluar deri ne 20kË. Lënda djegëse qe do të perdoret do te jete vetem nafta, e cila do te sherbeje per funksionimin e mjeteve te renda (mjete per gerrmim, ngarkim, transport dhe rrulim) ose per gjeneratore. Nafta do të sigurohet nga operatore te tregtimit te lëndeve djegëse dhe do te transportohet me autobot te specializuar dhe licensuar per transport lendesh te rrezikshme.

### **3.1.10 Rrezikshmeria, siguria në punë dhe mbrojtja nga zjarri**

Nisur nga kategoria I-rë e hidrokarburit me pikë flakërimi 32-33°C, konsiderohet si lëndë me rrezikshmeri të lartë. Kapaciteti aktual i prodhimit të kompanis BPAL, rreth 3300 ~ 3500m<sup>3</sup> në ditë si dhe projekcionin për shtimin e kapacitetit prodhues me 3% në vit deri në max prej 7100 m<sup>3</sup>/ditë. Sasia/Kapaciteti maksimal i vagonave çisternë nuk do të jetë më i madh se 62ton secili, si dhe do të ngarkohen njëkohesisht në 4 vagonë.

### **3.1.11 Menaxhimi i substancave të rrezikshme dhe toksike**

Toka e zonës së marrë në studim ka në përmbajtje sasi të lartë hidrokarburesh, metan(CH<sub>4</sub>) dhe metale të

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

renda, kryesisht nga rrjedhjen e hidrokarbureve si pasojë e shkarkimeve dhe avarive gjatë aktiviteteve të mëparshme për ngarkimin dhe transportimin e naftës bruto. Ndërkohë, bazuar në operacionet e punës (ngarkimin dhe transferimin e naftës bruto) si dhe praninë e pakët të lëndëve të tjera të rrezikshme, është parashikuar që krahas planit të menaxhimit dhe rehabilitimit mjedisor, do të aplikohen edhe masat në vijim:

- Kualifikimi i personelit mbi baza të rregullta;
- Inspektim ditor në vend,
- Informimin e shkelësve potencialë lidhur me rrezikun e materialeve të rrezikshëm dhe toksik që mund të paraqiten,
- Restaturimi paraparak i tokave të kontaminuara me metale të rënda,
- Zbatimin e udhëzimeve gjithëpërfshirëse për çështjet e shëndetit dhe ato të sigurisë(OHS) gjatë operimit,

Në çdo situatë e cila duket se shkel kërkesat e OHS, punonjësit do të mbahen larg zonës deri sa çështja të zgjidhet.

### **3.1.12 Pronesia mbi tokën dhe objektet industriale**

Pronësia e objekteve industriale është ende në proces përcaktimi, e ndarë mes Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, subjekteve që e kanë privatizuar, pronarëve potencial që do blejnë pronat pas likuidimit etj. Për këto arsye, edhe investitorët e interesuar për të zhvilluar projekte transformuese në zonë, janë tërhequr pas një kohe të shkurtër.

## **4. ALTERNATIVE PROJEKTIT**

Alternativat lidhur me projektin kanë të bëjnë me identifikimin e alternativave më të favorshme se alternativa e propozuar përse i përket vendit të përzgjedhur dhe nëse bëshmëria e projektit është më favorizuar se mos bërja e tij. Siç përshkruhet në kapitullin 3.2, zona e propozuar gjendet brenda një zone ish-industriale, ku gjenden ish Azotiku, Rafineria e Naftës, depozitat e naftës, etj. Pranë zonës së Rafinerisë së Naftës, ndodhet infrastruktura ekzistuese hekurudhore, në të cilën do të zbatohet dhe projekti i rehabilitimit. Sic u përmend edhe më sipër, ky projekt do të ndërmerret masa mjedisore rehabilituese dhe për objektet e banimit në afërsi të kësaj zone, të cilët janë të prekur nga objektet industriale.

### **4.1 Avantazhet e bërjes së projektit**

Opsioni “të mos bëjmë asgjë”/” alternativa zero”/”jo SN/ është e pafavorshme, sepse nënkupton

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

transportimin e naftës nëpërmjet autoboteve nga depozitat e Banker për në Portin e Vlorës. Ndërtimi i SN dhe rehabilitimi i linjës hekurudhore do të mundësojë transportin e naftës nëpërmjet linjës hekurudhore, duke lehtësuar trafikun në aksin Fier- Vlorë, dhe rrjedhimisht aksidentet rrugore, si dhe do të reduktojë ndotjen e ajrit nga qarkullimi i përditshëm i kamionëve për të transportuar sasinë gjithnjë e në rritje të naftës. Edhe nga pikëpamja ekonomike alternative është zgjidhja më e favorshme. Ndërkohë duke qenë se zona ku shtrihet ish stacioni i ngarkimit dhe ish infrastruktura hekurudhore është e kontaminuar, projekti do të mundësojë pastrimin e mbetjeve hidrokarbure, ndërkohë që mosbërja e tij do të paraqiste një kosto për autoritete në nivel qendror dhe lokal për pastrimin e zonës. Pra rrjedhimisht do të ketë një përfitim të drejtpërdrejt mjedisor dhe përfitim ekonomik për autoritete përgjegjëse.

#### 4.2 Avantazhet e zonës së përzgjedhur për stacionin e transferimit

Zona e përzgjedhur ka avantazhe ndaj opsioneve të tjera alternative sepse:

- I. Zbatohet në një zonë/ infrastrukturë ekzistuese të përdorur më parë për të njëjtën funksion, shoqëruar me rehabilitimin e stacionit dhe dekontaminimin e zonës; Për më shumë, ndodhet në një zonë industriale;
- II. është në afërsi të infrastrukturës hekurudhore ekzistuese, që pritet të rehabilitohet dhe bëhet funksionale; kjo do të eliminojë lëvizjen e kamioneve për transportin e hidrokarbureve;
- III. në afërsi të zonës së depozitimit të naftës që lehtësisht do transferohet në stacionin e ngarkimit nga depozitimi të ndërmjetëm në zonën e stacionit apo në një vend të ndërmjetëm. Në afërsi të zonës së rafinerisë së naftës për të pasur më të lehtë transportimin e produktit që do të vijë me tubacion nga depozita e naftës bruto të Bankers Petroleum, të ndërtuara pranë murit rrethues të rafinerisë së Fierit, dhe do të shpërndahet në katër tubacione më të vegjël të cilët do të ngarkojnë njëkohësisht 4 vagonë çisternë;
- IV. shqetësimi për ujërat nëntokësore, florën dhe faunën, aktivitetet bujqësore do të jetë më i vogël;
- V. nuk ka plane të parashikuara, as afatgjata, për zhvillimin e zonave të shqyrtuara (konkretisht, infrastrukture turistike, industri, bujqësi, park apo peisazh i rëndësishëm së veçantë, si dhe nuk lejohen zhvillimet urbane dhe ndërtesat rezidenciale.

Përsa më lart, çdo opsion tjetër alternativ është më pak i favorshëm në krahasim me zonën e përzgjedhur.

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTAES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

## 5. PËRSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT

### 5.1 Vendndodhja e zones dhe mjedisi rrethues

Zona e përzgjedhur ndodhet rreth 4 km larg Qytetit të Fierit, ne jug- perëndim, në rrugën që lidh qendrën e Fierit me zonën industriale te Rafinerise te Fierit.Zona industiale e Rafinerisë ndodhet përgjatë aksit që lidh Levanin me Fierin.Zona e propozuar për ndërtimin e stacionit tëri të ngarkimit të naftës ndodhet ne brendësi te zonës industriale se Azotikut, në vendin e ish-stacionit i ngarkimit të vagonave çisternë në Rafinerinë e Fierit, pozicionuar në pjesën veri-perëndimore të Rafinerisë. Ky stacion lidhet me hekurudhën në stacionin e mallrave Fier, me një linjë hekurudhore që shtrihet për 2.5km dhe ndahet në tre degë. Me një sipërfaqe prej rreth 60 ha, zone industriale përfshin gjithashtu Parkun Industrial të Prodhimit të Azotit, zonën e Rafinerisë së Naftës, si dhe ish-TEC-in. Zona e Rafinerise së Naftës ndodhet rreth 3km nga qyteti i Fierit dhe 6 km nga autostrada Fier-Levan.

Zona e stacionit te ngarkimit ndodhet ne fshatin Drize, nen administrimin e njesise administrative Qender Fier. Driza ndahet ne dy lagje Drize Bare dhe Drize Hoxha, Stacioni dhe drejtimi i linjes hekurudhore ndodhen ne afersi te lagjes Drize Bare, ku ka 110 shtepi me rreth 400 banore. Ndertesat e banimit me te aferta me Stacionin kane nje largesi prej 70 deri 90m, distance ne vije ajrore. Kryesisht jane ndertime informale te bera pas viteve '90.



Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTAES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER



Figure 8: Përdorimi i tokës pranë zonës së projektit

## 5.2 Toka

Nga pikëpamja gjeologjike zona ndodhet në nën-zonën gjeotektonike të Kurveleshit, e cila karakterizohet nga depozitime të përziera aluviale-proluviale: rëra, zhavore, alevrite. Moshë gjeologjike është Pleistocen – Holocen. Një pjesë e vogël e sipërfaqes i përket moshës gjeologjike Holocen, përbërë nga depozitime aluviale: alevrite, rëra, zhavore. Në përgjithësi në këtë zonë mbizotërojnë tokat e hirta kafe që gjenden në rrjedhën e poshtme dhe pjesërisht të lumenjve përshkruar. Varjojnë nga kuotat 0-600(m) mbi nivelin e detit.

Karakteristikë e kësaj zone janë tokat e kripura, që kanë origjinë detare dhe janë të përhapura në fushat bregdetare të pjesës perëndimore të Shqipërisë (fusha e Honxhës). Në këtë zonë bimët nuk arrijnë të rriten shumë pasi akumulojnë pak lëndë organike, prandaj nuk luajnë një rol të rëndësishëm në shpejtimin e procesit tokë-formues dhe në përmirësimin e cilësive fizike të tokës.

Zona kodrinore ku shtrihen këto lloj tokash përshkrohet nga përrenj me gjerësi dhe thellësi të ndryshme, në varësi të shkallës së zhvillimit të tyre. Pjesa e rrafshët e relievit, ku përhapen tokat livadhore të hirta kafe, përshkrohet nga lumenjtë: Semani dhe Vjosa. Tokat livadhore të hirta kafe që gjenden në zonen fushore

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTAES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

bregdetare. Nga pikëpamja pedogjenetika, këto toka ndodhen në ndikim e procesit te livadhit. Formohen mbi depozitime kuartenare, të përbëra nga aluvione, deluvione dhe depozitime detare.

### 5.2.1 Përdorimi i tokës

Refereuar Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fier, nga 620km<sup>2</sup> që është sipërfaqja totale e Bashkisë Fier, 435.82km<sup>2</sup> është tokë bujqësore (këtu përfshihen tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe 127.87km<sup>2</sup> është tokë natyrore (pyje, kullota). Bashkia Fier përshkohet nga lumi i Semanit dhe Gjanica dhe është e pasur me ujëra nëntokësore e burime ujore sipërfaqësore. Sipërfaqja totale ujore zë 9.8km<sup>2</sup>.

Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 4.3km<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja që zënë shërbimet është 1.16km<sup>2</sup>. Institucionet, shëndetësia dhe arsimit zënë një sipërfaqe prej 2.1km<sup>2</sup> dhe janë të përqendruara në qytetin e Fierit dhe fshatrat kryesore të njësive.

### 5.2.2 Erozioni i tokave bujqësore

Bashkia e Fierit shtrihet në një zonë me reliev kryesisht fushor dhe në disa zona të caktuara kodrinor, tejet i përshtatshëm për bujqësi dhe aktivitetet të tjera ekonomike. Problematika kryesore që po hasen në zhvillimin e bujqësisë në Fier lidhen kryesisht me degradimin e tokave për shkak të erozionit, kripëzimit, kënetëzimit, përmbytjeve, gërryerjeve të tokës dhe shembjes së brigjeve të lumenjve shkaktuar nga Semani e Vjosa, si dhe ndotja e tokës nga mbetjet, industria (ku dallohet industria e naftës) dhe inputet bujqësore. Për sa i përket erozionit në tokat bujqësore, ndërsa në vendi tonë rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë, në Qarkun e Fierit konsiderohet i lartë.

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER




Figure 9: Zonimi Gjeoteknik (burimi SHBSH)

### 5.3 Zonat e nxehta mjedisore

Në Bashkinë Fier, industria ka qenë boshti kryesor i zhvillimit të kësaj Bashkie si kryeqendër e rajonit, e fokusuar në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të naftës dhe prodhimin dhe riciklimin e vajrave.

Sipas raportit të UNECE-s mbi hotspotet në vendin tonë, të hartuar në vitin 2012372, Bashkia e Fierit ka dy vatra të nxehta mjedisore që janë Uzina e Plehrave Azotike dhe zona naftënxjerrëse Patos-Marinëz. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i këtyre dy vatrave.

**Uzina e Plehrave Azotike në Fier** është identifikuar si zonë e nxehtë mjedisore. Në të ruhen ende në fuçi 25 ton NH<sub>3</sub> të lëngshëm, bakër dhe amoniak. Toka përreth uzinës rezulton e ndotur me nikel (Ni) në disa seksione të saj. Sipas AKM-së, me largimin nga objekti industrial nuk vihet re një ulje e ndjeshme e nivelit të përmbajtjes së metaleve të rënda përveç manganit dhe nikelit 373.



Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

**Zona naftëxjerrëse Patos-Marinëz**, Ballsh e Fier, edhe pse nuk është përcaktuar si vatër mjedisore, sipas raportit të UNEP-it, është e ndotur rëndë me hidrokarbure<sup>374</sup>. Në fushat e naftës në Patos–Marinëz, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore po ndoten rëndë nga pusët e naftës, pompat, tubacionet, stacionet paratrajtuese. Në atmosferë po shkarkohen gazra sulfurike dhe hidrokarbone. Ujërat me përmbajtje mbetje të naftës po shkarkohen në lumë duke ndotur Gjanicën dhe mbase edhe duke ndikuar në cilësinë e ujërave të përdorura për pije<sup>375</sup>.

**Ndotje nga Rafineria e Naftës:** Në ambientet e ish-TEC-it në Fier, ushtron aktivitetin Rafineria e Naftës e cila është vrotuar tek gjeneron ndotje në gjendje të gaztë dhe të lëngët. Krahasimisht me vite më parë, kur intensiteti i aktivitetit të kësaj hapësirë industriale ka qënë i lartë, ndotja në ajër konsiderohet se është reduktuar ndjeshëm si pasojë e aktivitetit të reduktuar në këtë zonë.

## 6. IMPAKTET POTENCIALE TË PROPOZIMIT DHE MASAT ZBUTËSE

### 6.1 Hyrje

Kjo pjesë identifikon dhe analizon ndikimet që mund të shkaktohen nga aktivitetet e propozuara të projektit. Si bazë për vlerësimin do të përdoren kushtet aktuale natyrore brenda zonës së projektit duke përfshirë rreziqet dhe ndikimet që nuk lidhen me projektin, por të identifikuar në përshkrimin e mjedisit ekzistues të projektit.

#### **Burimet e Ndikimit gjatë ndërtimit dhe funksionimit të SN**

- Faza ndërtimore: Përgatitje e zonës të punës; gërmime dhe ruajtje e përkohshme e materialit të gërmuar, lëvizja e automjeteve, pajisjeve dhe personelit; Përdorimi i ujit dhe materialeve të papërpunuar; Menaxhimi i ujërave kullues sipërfaqësor; menaxhim i mbetjeve, etj..
- Faza e funksionimit (operimit) dhe mirëmbajtjes: ngarkimi i naftës nga depozita në vagonët, lëvizja e vagonëve përgjatë zonës së projektit, mirëmbajtja e pajisjeve dhe personelit; Menaxhimi i mbetjeve, etj;

#### **Receptorë me Potencial për t'u Ndikuar**

- Ajri, Toka, Habitate, Flora Dhe Fauna.
- Kushtet e Veçanta Bazë që janë Ndikime me Influcencë Potenciale
- Zona me aktivitet të lartë njerëzorë.

#### **Faktorë të Projektit që janë Ndikime me Potencial për të Influencuar**

Menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i trafikut, gjerësia e punës për korridorin e hekurudhës, koha e punimeve, niveli i ndikimeve fizike (d.m.th. zhurmat, drita, vizuale, dridhje, cilësia e ujit).

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

## 6.2 Përmbledhje e ndikimeve potenciale mjedisore

Zona e ndikuar	Ndikimi Potencial /Burimi	Zona e ndikimit
Ujëra sipërfaqësor dhe nëntokësor	<p>Ndotja e ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor si rrjedhojë e rrjedhjeve/shkarkimeve të pakontrolluara nga automjetet, makineritë, ujërat e ndotur dhe ujërat e zeza, derdhjet aksidentale të materialeve të rrezikshme si për shembull karburant, lëndë kimike, mbetje, etj.</p> <p>Ndotja e ujërave nëntokësorë mund të ndikojë tek burimet ujore nëntokësore që përdoren për ujin e pijshëm.</p>	Distancë specifike lokale deri në 100 metra
Toka	<p>Ndotja e tokës mund të ndodhësi rrjedhojë e rrjedhjeve/shkarkimeve të mundshme nga automjetet, makineritë, ujërat e zeza dhe të ndotura, derdhje aksidentale të materialeve të rrezikshme si karburante, lëndë kimike, mbetje, etj.</p> <p>Ndotja e tokës mund të ndikojë ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor, burimet dhe pusët për ujin e pijshëm etj.</p> <p>Toka është e ekspozuar nga fenomeni i erozionit dhe sedimentimit për shkak të tokave të ekspozuara dhe aktiviteteve të gërmimit në zonën e projektit;</p>	Distancë specifike lokale deri në 100 metra
Cilësia e Ajrit	<p>Ndikimet nga emetimet e automjeteve, pajisjet me djegje, aksidente ose defekte të sistemit (d.m.th., aksidente);</p> <p>Trafiku i automjeteve dhe aktiviteteve operacionale (ngarkimi ose shkarkimi i automjeteve) në rrugë me çakull ose tokë e ekspozuar gjatë lëvizjes që mund të shkaktojë krijimin e pluhurit;</p> <p>Clirimi i emetimeve në rast aksidentesh (d.m.th. zjarret) mund të bëhet i rrezikshëm për mjedisin, punonjësit dhe banorët, si rrjedhojë e përmbajtjeve të rrezikshme dhe afërsisë së objekteve të banimit.</p> <p>Krijimi i pluhurit mund të përkeqësojë cilësinë e ajrit brenda</p>	<p>Në nivelin lokal me qindra metra deri në një kilometër në kushte të caktuara të pafavorshme meteorologjike;</p> <p>Komunitetet që përdorin dhe punojnë aktualisht përgjatë rrugëve në të cilat do të kalojnë automjetet e projektit;</p>

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

	<p>bazës së furnizimit ose të shqetësojë banorët përreth.</p> <p>Clirimi i pakontrulluar i gazrave të dëmshëm (H<sub>2</sub>S<sup>2</sup>) në pajisjet dhe makineritë që transferojnë dhe ngarkojnë naftën bruto.</p>	Në zonën e projektit, ku punonjësit mund të ekspozohen;
Zhurma dhe vibrime	<p>Ndikime nga emetimi i zhurmave gjatë operacionit normal të stacionit të ngarkimit (d.m.th. automjetet, pajisjet shpërthyes/mekanike). Ngjarje jo rutinë si për shembull ngjarje emergjence.</p> <p>Receptorët e zhurmës do të përfshijnë popullsinë rezidenciale (dhe receptorë të ndjeshëm si shkollat), punonjësit, fauna, etj.</p>	Në nivel lokal, komunitetet që përdorin dhe punojnë aktualisht përgjatë rrugëve në të cilat do të kalojnë automjetet e projektit
Burimet dhe mbetjet	<p>Mbetjet dhe ujërat e ndotur të krijuar nga gjatë operacionit dhe mirëmbajtjes. Kjo përfshin mbetje të krijuara nga aktivitetet që lidhen me stacionin si aktivitete të ngarkimit të naftës dhe aktivitete të tjera mbështetëse për funksionimin e impantit (d.m.th. magazinimi i për pajisjeve për shpime, pjesë rezervë, etj.);</p> <p>Depozitimi i pakontrolluar i materialeve të rrezikshme mund të ndotë tokën, ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor, burimet ujore (ujin e pijshëm) dhe të rrezikojë kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë.</p>	Brenda impantit të ngarkimit, në nivel lokal, distancat e përafërta varen nga kushtet lokale
Shëndeti dhe siguria në punë dhe e komunitetit	<p>Ndikimet në shëndet dhe në siguri nga emetimet e rrezikshme, magazinimi i pakontrolluar i lëndëve kimike, dëmtimeve nga rëniet dhe makineritë dhe aksidente të tjera të ngjashme (d.m.th. në rast zjarri).</p> <p>Megjithëse ka pak mundësi, projekti mund të krijojë rreziqe për shëndetin dhe sigurinë e personelit;</p> <p>Projekti ka potencial për të pasur ndikim mbi komunitetet fqinje nëpërmjet ndryshimeve në nivelin e zhurmave dhe cilësinë e ajrit, etj.</p>	Brenda 100 metrave në nivel lokal
Popullsia lokale	Çdo shqetësim mbi trafikun lokal (lëvizja e kamionëve mund të bezdisin banorët përgjatë rrugës së aksesit), krijimi i pluhurave dhe ndotja e burimeve të ajrit dhe ujit nga çdo	Në nivel lokal, qindra metra deri në një

<sup>2</sup> H<sub>2</sub>S është një gaz shumë toksik dhe i ndezshëm (gamma e ndezjes: 4.3-46%). Duke qenë më i rëndë se ajri, ajo tenton të grumbullohet në fund të hapësirave me pak ventilim. Megjithëse në fillim shumë i athët, ajo shpejt ngadalëson ndjenjën e nuhatjes, kështu që viktimat mund të jenë të pavetëdijshme për praninë e saj derisa të jetë tepër vonë;

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

	emetim ose shkarkim aksidental, etj.  Për më tepër, aktivitetet e bazës së furnizimit do të ofrojnë përfitime të kufizuara, kryesisht mundësi punësimi për banorët lokalë.  Përfitime ekonomike për familjet dhe për ekonominë lokale si rezultat i drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt i projektit.	kilometër
Kushtet e punës	Rreziqe të dëmtimit të fuqisë punëtore si rezultat i aktiviteteve operacionale rutinë të projektit si për shembull mirëmbajtja.	Brenda bazës së furnizimit, në nivel lokal.

### 6.3 Ndikimet Potenciale dhe masat zbutëse

#### 6.3.1 Ndikimet në Cilësinë e Ajrit

Pritet të ketë ndikime të lokalizuara dhe të përkohshme në cilësinë e ajrit në zonë si rrjedhojë e emetimeve atmosferike gjatë fazave të ndërtimit. Dy burimet kryesore të emetimeve atmosferike që kanë potencial për të ndikuar negativisht cilësinë e ajrit gjatë ndërtimit të SN janë emetimet e pluhurit nga punimet inxhinierike dhe emetimet e gazrave nga pajisjet dhe automjetet e përfshira.

Në lidhje me shtrirjen hapësinore të ndikimeve, emetimet e pluhurave do të lëshohen më së shumti në afërsi të zonës së ndërtimit. Cdo ndikim që lind nga emetimet e pluhurit nga punimet inxhinierike do të jetë i përkohshëm dhe me një kohëzgjatje të shkurtër.

Për sa i përket emetimeve të gazit, pritet të ekzistojë një situatë e njëjtë, ku trafiku i ndërtimit në zonën e ndikimit të devijimit do të jetë i kufizuar gjatë kohëzgjatjes së aktiviteteve.

Një tjetër impakt negativ lidhet me clirimin e gazeve të dëmshme, clirimin e H<sub>2</sub>S, një gaz tejet i rrezikshem per jeten e njerëzve që clirohet gjatë procesit të operimit. Clirimeve të pakontrulluara të këtij gazi pritet të jetë një zgjidhje teknologjike. Kështu, gazi qe del gjate ngarkimit nuk do të shkarkohet ne atmosphere por te rikthehet perseri ne depo. Ky eshte nje kusht i pa negociushem qe duhet te permbushe ky stacion duke pasur parasysh tipin dhe sasine e gazit H<sub>2</sub>S.

#### Masat zbutëse:

Projekti do të mundësojë pajtueshmërinë me standardet Shqiptare të emetimeve për zonën e projektit. Parandalimi i krijimit të emetimeve, zhurmave dhe pluhurit dhe masat zbutëse për të zvogëluar ndikimet potenciale do të zbatohen për të garantuar emetime brenda niveleve të lejueshme në një distancë prej 300 metrash nga vendodhja e zonës.

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

## Pluhuri

Trafiku i automjeteve në rrugë me çakull apo të pashtuara dhe aktiviteteve operacionale mund të jetë një burim për krijimin e pluhurit. Rrugët e aksesit duhet të jenë të ujitura rregullisht afër komuniteteve kur është e nevojshme që të kontrollohet pluhuri.

## Automjetet/ Menaxhimi i Transportit

Të gjitha automjetet që lidhen me projektin dhe që përdoren nga Kompania, kontraktorët dhe nën-kontraktorët duhet të pajtohen me normat për kalim të sigurt dhe mbrojtje mjedisore.

Teknologjia e SN do të mundësojë rikthimin e gazrave në mënyrë që gazi që del gjatë ngarkimit të mos shkarkohet në atmosferë por të rikthehet perseri në depo.

### 6.3.2 Ndikimet e Zhurmave

#### Gjatë fazës së ndërtimit

Ndikimet e zhurmave në rastin e cilësisë së ajrit priten që të jenë të lokalizuara dhe të përkohshme, duke marrë parasysh se burimet e ndikimit janë të njëjta, si për shembull përgatitja e zonës së ndërtimit, dhe përdorimi i automjeteve dhe trafiku. Receptorët potencialë në zonë përbëhen kryesisht nga ndërtimet informale përreth. Burimet e zhurmave në këtë fazë nuk do të jenë të vazhdueshme (kryesisht gjatë ditës), dhe do të varen nga numri dhe lloji i makinerive të përdorura për çdo aktivitet. Nivelet normale të zhurmave 1 m larg nga burimi janë të përmbledhura në tabelën më poshtë:

**Tabela 1: Nivelet e Zakonshme të Zhurmave për Pajisjet e Ndërtimit**

Lloji i Pajisjes	Niveli i Zhurmave sipas makinerive (1 m larg nga burimi)
Ekskavator	70 - 84 dBA
Ngarkues me kazan	70 - 84 dBA
Vinç	70 - 84 dBA
Vinç me krah anësor	84 – 99 dBA
Gjenerator me motor	70 - 84 dBA
Makineri saldimi	70 - 84 dBA

#### Gjatë fazës së operimit

Gjatë fazës së operimit, pritet të ketë emetime të zhurmave si pasoje e përdorimit të makinerive për ngarimin e naftës nëpër vagonë si dhe lëvizjeve të vagonëve në zonën e projektit.

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

Duke iu referuar Limiteve të lejuara të zhurmave (Nr. 8 datë 27.11.2007), vlera e lejuar për për trafikun është is LAeq = 70 dB(A) për 24 orë dhe vlera maksimum LAmaxfast =110 dB(A).

#### **Masat lehtësuese/ zbutëse:**

Për të trajtuar çështjet e zhurmës dhe dridhjeve, Kompania do të mundësojë mirëmbajtje dhe monitorim për burimet kryesore të emetimit të zhurmave dhe vibrimeve (si psh. për gjeneratorët, etj.), do të shmang operacionet gjatë natës dhe do të përdor zbutje specifike për pajisjet e zhurmshme.

#### **Shkalla e rëndësisë: E Ulët**

#### **Ndikimet e mbetura:**

Pavarësisht masave për reduktimin dhe mënjanimin e zhurmave, një pjesë e zhurmave mund të jenë të pashmangshme, si psh.zhurma e makinerive (pompave) gjatë ngarkimit të naftës në vagonë ose zhurma e krijuar nga lëvizja e trenit. Kompania do të marrë masa lehtësuese për të përmbushur normat e lejuara për zhurmat tek receptorët semsitive (banesat pranë SN), nëpërmjet barierave mbrojtës si dhe kufizimit të shpejtësisë së lëvizjes të trenave.

#### **6.3.3 Ndikimet në tokë**

Punimet e ndërtimit të SN parashikojnë punimet ndërtimore në tokë, si më poshtë:

- Ndertim rruge aksesit;
- Prerje bime te vogla (shkurret ne te dy skarpatet e zonës dhe linjës hekurudhore);
- Pastrim kanalesh ekzistuese, me makineri;
- Germim i seksionit per kanalet te rinj me makineri(dy kanale anesore pergjate trasese per drenazhim ujrash sipërfaqësorë);
- Germim+pastrim traseje ekzistuese nga llumrat.

Ndotja e tokës mund të ndodhë brenda ose përreth bazës së ngarkimit me naftë si rrjedhojë e derdhjeve të mundshme, mbetjeve dhe lëndëve të rrezikshme ose organike.

Toka e zonës së projektit është e ekspozuar ndaj erozionit sidomos në tokat e gërmuara ku erozioni është i pranishëm. Ndërkohë punimet për ndërtimin e stacionit dhe rehabilitimin e linjës hekurudhore (gjatë punimeve të gërmimeve dhe transportit të dherave) mund të shtojnë erozionin dhe sedimentimin.

#### **Masat Zbutëse:**

Operacionet e personelit dhe makinerive duhet të kufizohen vetëm në zonat e funksionimit. Operatori duhet të sigurojë që të mos ketë derdhje të naftës ose derdhje të lëndëve kimike brenda zonës

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

operacionale dhe, në rast të derdhjeve aksidentale ky material duhet të neutralizohet siç duhet. Nevojiten të merren masa për mbrojtjen e tokës së ekspozuar nga erozioni sipërfaqësor si dhe ngritjen e barrierave për parandalimin e sedimentimit gjatë eventeve me reshje të medha. Nevojiten të merren masa për kontrollin e ujrave sipërfaqësorë dhe shmangjen nga zonat e ekspozuara ose marrjen e masave për mbrojtjen e tokës së ekspozuar.

**Shkalla e rëndësisë:** E moderuar

#### **6.3.4 Ndikimet ne ujë (sipërfaqësore dhe nëntokësorë)**

Punimet ndërtimore për rikonstrukcionin e linjës hekurudhore nga stacioni i ngarkimit të naftës bruto drejt linjës hekurudhore ekzistuese Fier-Vlorë (Km 85+625 – Km 87+700) nuk pritet të ndikojë në burimet ujore përgjatë zonës së projektit. Në zonën ku do zhvillohen punimet është korridori i linjës së mëparshme hekurudhore, ku nuk kemi asnjë kryqëzim me trupa/ vija ujore, pra nuk kemi ndikime ujrave sipërfaqësorë. Zakonisht, aktivitetet që lidhen me projektin e SN do të kërkojnë sasi të vogla uji nga burimet lokale, kryesisht për larje and përdorime të brendshme, dhe potencialisht për masat për mbrojtjen kundra zjarrit.

##### **Masat Zbutëse:**

Stacioni i ngarkimit të naftës do të vendoset në një zonë të mbrojtur dhe të rrethuar nga një vaskë me shtresë hidroizoluese, ndërkohë vendet e ruajtjes dhe qarkullimit do të jetë e betonuar dhe një sistem kullimi dhe grope për grumbullimin e rrjedhjeve aksidentale të substancave kimike, për të siguruar që mbetjet ose kimikatet nuk do të shkarkohen në tokë apo ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Pompat e transferimit do të instalohen për të parandaluar ndotjen e tokës ose minimizuar derdhjet nga baza e strukturës.

**Shkalla e rëndësisë:** E moderuar

#### **6.3.5 Ndikimet nga mbetjet**

Priten të gjenerohen sasi të vogla mbetjesh urbane, si mbetje të ngurta ashtu dhe ujëra të ndotur urbane.. Gjatë fazës së ndërtimit dhe fazës së operimit mund të krijohen mbetje të rrezikshme, për shëmbull materialesh dherash të kontaminuar me hidrokarbure të cilat kërkojnë të magazinohet dhe trajtohen në mënyrë të vecantë nga mbetje të tjetra dherash apo inerte që dalin nga procesi i ndërtimit.

##### **Masat Zbutëse:**

Mbetjet do të dorëzohen pranë operatorëve të licensuar për grumbullimin e tyre sipas kërkesave ligjore. Në asnjë rast nuk do të lejohet abandonimi i mbetjeve në natyrë apo në vende jo të miratuara për grumbullimin dhe depozitimin e tyre.

Të gjitha mbetjet e rrezikshme do të mbledhen dhe shpërndahen jashtë zonës në një stacion për

Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme të licencuar nga qeveria për trajtim të veçantë dhe depozitim. Mbetjet të krijuara papritmas nga çdo aksident do të mblidhen dhe ruhen veçmas dhe nuk do të përzihen me materiale të tjera mbetjesh (si për shembull kontejnerë, pjesë rezervë plastike ose metalike të përdorura, etj.) deri në heqjen e tyre nga stacioni.

Vajrat lubrifikues, tretësit, dhe lëndët vajore duhet të riciklohen si duhet, për t'iu dorëzuar kompanive të licencuara ose transportuar në impiante me djegje (prodhimin e energjisë, furrat e çimentos etj.) ku mund të përzihen me karburant dhe të digjen.

Të gjitha mbetjet jo të rrezikshme të krijuara nga aktivitetet në SN duhet të ndahen dhe klasifikohen përpara se të ngarkohen në kamionë dhe të çohen në landfille urbane.

Të gjitha mbetjet ujore duhet të pajtohen me standardet dhe rregulloret në Shqipëri për cilësinë, temperaturën dhe aromën përpara se të shkarkohen në mjedis, përfshirë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 31 Mars 2005 "Mbi Normat e Shkarkimit të Ujërave të Ndotur".

#### **Shkalla e rëndësisë:**

e ulët për mbetjet urbane dhe e moderuar për mbetjet e rrezikshme (të gjeneruara nga shkarkimet aksidentale të naftës dhe hidrokarbureve në tokë)

#### **6.3.6 Ndikimi në biodiversitet**

Duke marrë në konsideratë gjëndjen ekzistuese të biodiversitetit në zonën e projektit dhe zonën përreth (një zonë industriale), ndikimet gjatë ndërtimit dhe operimit të SN do jenë minimale ose të papërfillshme.

#### **Masat zbutëse:**

Për të shmangur rrallimin e panevojshëm të faunës, flores dhe zonave me aktivitet bujqësorë aktiv, zona e ndërtimit do të kufizohet në zonën minimale që nevojitet për punime. Nuk duhet të ketë hedhje të materialeve jashtë zones. Materialet duhet të riperdoren dhe nese nuk është e mundur dherat dhe materialet e tepert duhet të depozitohen në një zonë të rene dakort me Bashkinë, ose të transferohen në zonën e ndërtimit ku nevojiten.

**Shkalla e rëndësisë:** e papërfillshme

#### **6.3.7 Shëndeti dhe siguria në punë dhe në komunitet**

Fuqia punërore që do të angazhohet gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit mund të ekspozohet ndaj niveleve të larta, afatshkurtra të zhurmës gjatë ndërtimit të stacionit të ri të ngarkimit të naftes bruto. Mbetjet e rrezikshme: në këtë zonë ekziston gjithnjë rreziku që krahu i punës të ekspozohet ndaj materialeve të rrezikshme të padeklaruara në mbetjet e përgjithshme.

Megjithëse ka pak të ngjarë, për qytetarët lokalë që banojnë afër mund të krijohen probleme për shëndetin



Kompania:	ABKons
Titulli I	RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS RIKONSTRUKSIONI I STACIONI HEKURUDHOR TË
Dokumentit:	NGARKIMIT TË NAFTES BRUTO DHE LINJES HEKURUDHORE NË FIER

dhe sigurisë në rastin e zjarreve ose aksidenteve.

#### **Masat Zbutëse:**

Kompania duhet të marrë masat e duhura për të parandaluar aksidentet, duke siguruar magazinimin e sigurt të hidrokarbureve dhe pajisjeve për zhvendosjen transportimin e tyre, të mbrojtur nga dëmtimet mekanike dhe dëmtimet e brendshme, të mbrojtur nga temperaturat ekstreme, flakët, dhe të mbuluara/mbyllura pa qenë të ekspozuara direkt ndaj diellit, etj.

Kompania duhet të garantojë sigurinë dhe mjetet e ndihmës së parë brenda SN, monitorët dhe sistemet e alarmit, pajisjet kundër zjarrit, etj.; për të siguruar që të gjithë punëtorët të jenë pajisur me pajisje të sigurta dhe për të siguruar përdorimin e tyre.

**Vlerësimi i Rëndësisë:** E Moderuar

#### **6.3.8 Ndikimet mbi popullsinë lokale**

Cilësia e jetës në komunitetin lokal përreth ka pak të ngjarë që të ndikohet nga aktivitetet që kanë lidhje me projektin. Për më tepër, aktivitetet e SN do të ofrojnë përfitime të kufizuara, kryesisht mundësi për punësim për banorët vendas.

#### **Masat Zbutëse:**

Mekanizmi i ankesave do të përdoret për të lehtësuar identifikimin e hershëm dhe rregullimin e menjëhershëm për ata që besojnë se janë dëmtuar ose shqetësuar nga operacionet e SN. Do të sigurojë që ankesat nga komunitetet e ndikuara dhe komunikimet nga grupet e tjera të interesit të marrin përgjigje menjëherë dhe të menaxhohen si duhet.

**Vlerësimi i Rëndësisë:** I ulët

## **7. PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR**

Plani i Monitorimit Mjedisor është hartuar që të monitorojë operimin dhe masat zbutëse të përcaktuara në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe ndikimet që lidhen me SN e në Fier. Këto procedura referohen në këtë VNM, dhe formojnë një pjesë të regjimit të menaxhimit sipas së cilit do të ndërmerret projekti. Procesi i Vlerësimit raportuar në këtë VNM ka identifikuar nevojën për masa shtesë specifike zbutëse për të siguruar që projekti i SN në Fier të ketë ndikimet më të vogla të dëmshme mjedisore dhe sociale.

Masat specifike për t'u ndërmarrë gjatë fazës operacionale të projektit janë të përfshira në tabelën e mëposhtme. Tabela përfshin gjithashtu masat monitoruese të hartuara për të siguruar pajtueshmëri me planet që mund të kontrollohen dhe dokumentohen gjatë zbatimit, dhe për të caktuar përgjegjësi për këto veprime.


<b>Çështjemjedis ore/sociale</b>	<b>Parametri që do të monitorohet?</b>	<b>Ku do të monitorohet?</b>	<b>Si do të monitorohet? Lloji i mjeteve për t'u përdorur</b>	<b>Kur do të monitorohet? (shpeshtësia)</b>	<b>Pse do të monitorohet?</b>	<b>Kush do te monitoroje?</b>
<b>Ndikimet në ujë</b>	Parametrat e ujit, Ujërat e ndotur	Rrjedha e poshtme e shkarkimeve të ujërave të ndotur (deri në 100 m); Shkarkimet e ujërave të ndotur në ujëra sipërfaqësor; Ujëra nëntokësor shembuj në vende shkarkimi.	Inspektim vizual, Kampionim dhe analizë laboratorike	Gjatë ndërtimit dhe operimit	Për të verifikuar pajtueshmërinë me kufijtë e lejuar të VKM-së No. 177 të Marsit 31, 2005 ose kufizime të tjera përkatëse.	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
<b>Ndotja e dheut/tokës</b>	Naftë dhe Graso Metalet totale Parametra shtesë në varësi të llojit të ndotjes	Derdhje substancash hidrokarbure, të rrezikshme, magazinimi i mbetjeve dhe lëndëve kimike	Inspektim vizual, nëse kërkohet kampionim dhe analizë laboratorike;	Gjatë ndërtimit dhe operimit	Për të zbuluar dhe zbutur çdo ndotje të tokës	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
<b>Cilësia e ajrit</b>	Parametrat e ajrit	Burimet e zjarrit/ tymi (për incidente)  Ndotje me pluhur dhe ajër gjatë ngarkimit dhe transportimit	Mjete për kontrollin e cilësisë ajrit (Tuba)	Gjatë ndërtimit dhe operimit	Për të siguruar cilësinë e ajrit, kryesisht afër zonave të banuara  Pajtueshmëri me standardet e cilësisë së ajrit dhe adresim i ankesave te publikut	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale
<b>Zhurma</b>	Niveli i zhurmës në mjedis (Leq, Max SPL, Min SPL)	300 metra nga aktivitetet e projektit	Instrument i zhurmës	Inspektime rutinë bazuar mbi inspektimin e ankesave  (mjetet përkatëse)	Verifikim i pajtueshmërisë me kufijtë e lejuar; Për të siguruar cilësinë mjedisore, shëndetin dhe sigurinë.	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektoriati Mjedisor, Autoritetet Lokale

<b>Çështjemjedis ore/sociale</b>	<b>Parametri që do të monitorohet?</b>	<b>Ku do të monitorohet?</b>	<b>Si do të monitorohet? Lloji i mjeteve për t'u përdorur</b>	<b>Kur do të monitorohet? (shpeshtësia)</b>	<b>Pse do të monitorohet?</b>	<b>Kush do te monitoroje?</b>
<b>Dridhjet/ vibrimi</b>	Matja e vibrimit	Tek zonat deri ne 300 metra nga aktivitetet e projektit	Instrument	Inspektime rutinë bazuar mbi inspektimin e ankesave	Për të siguruar cilësi mjedisore,shëndet dhe siguri.	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor, Autoritetet Lokale
<b>Krijimi i mbetjeve</b>	Rrezikshmëria/ toksiciteti	Zona e ruajtjes së mbetjeve, magazina, zonat e tjera	Inspektimi Vizual  Fatura  Raporte  Analiza te mbetjeve nëse kërkohet	Inspektimet rutinë	Për të siguruar cilësi mjedisore,shëndet dhe siguri.  Pajtueshmëri me standardet e menaxhimit të mbetjeve	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor dhe i Punës, Autoritetet Lokale
<b>Shëndeti dhe siguria në punë</b>	Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse  Shenjat e Informimit vizual  Procedurat SHSM	Në zonë dhe mjediset përreth (nëse kërkohet)	Inspektimi Vizual  Raporte	Inspektimet rutinë	Për të siguruar cilësi mjedisore, shëndet dhe siguri.  Pajtueshmëri me standardet e menaxhimit të mbetjeve  Detyrim për të përdorur PPE dhe shërbimet sanitare.	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor dhe i Punës, Autoritetet Lokale
<b>Ndikimet mbi</b>	Pluhuri, cilësia e ujit dhe tokës, emetimet	Në zonë si dhe mjediset përreth (nëse	Inspektim vizual	Inspektime rutinë bazuar mbi	Për të siguruar cilësi mjedisore,shëndet dhe	Kompani ose kontraktor

<b>popullsinë lokale</b>	dhe shkarkimet, prania e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme	kërkohej)	Raportet  Masat nëse kërkohen	ankesat	siguri.  Pajtueshmëri me standardet e shëndetit dhe të sigurisë	Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor dhe i Punës, Autoritetet Lokale
<b>Ngarkesat dhe transporti</b>	Mbulimi dhe kontrollimi i ngarkesave për të mos shkaktuar shpërndarje/derdhje/shkarkime gjatë transportit për arsye sigurie.	Përgjatë rrugëve lokale	Inspektimi vizual  Raportet	Inspektimet vizuale (foto)	Shmangja e aksidenteve potenciale dhe shkarkimi i materialeve/substancave	Kompani ose kontraktor  Nëse kërkohet ARM/Inspektorati Mjedisor, Autoritetet lokale.

**Aneksi 1: Planimetria e stacionit të ngarkimit të naftes bruto dhe linjës hekurudhore sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE ( Pulkovo 1942 Gauss Kruger Zona 4N)**


# Kordinatat e Stacionit të Ngarkimit të Naftës



## Legjenda

- Pike Hekurudhe
- × Pike Terminali
- Hekurudha
- Terminali

Vendodhja: Fier  
Data: 20-04-2017  
Sistemi Kordinativ: Pulkovo 1942 Gauss Kruger Zona 4N  
Shkalla: 1:5000



Numb	X_Gauss_4N	Y_Gauss_4N	Numb	X_Gauss_4N	Y_Gauss_4N
T 1	377216.3777	4508840.2208	61	377086.9035	4509567.7057
T 2	377216.4770	4508839.9723	62	377084.5900	4509587.6360
T 3	377211.3117	4508852.8890	63	377082.2766	4509607.5663
T 4	377213.9660	4508853.9505	64	377079.9631	4509627.4966
T 5	377218.9556	4508855.9457	65	377077.6497	4509647.4270
T 6	377221.6099	4508857.0072	66	377075.3362	4509667.3573
T 7	377226.6758	4508844.3390	67	377073.0228	4509687.2876
T 8	377226.7752	4508844.0905	68	377070.7093	4509707.2179
T 9	377231.8411	4508831.4223	69	377068.3959	4509727.1483
T 10	377229.1868	4508830.3609	70	377066.0825	4509747.0786
T 11	377224.1973	4508828.3656	71	377063.7690	4509767.0089
T 12	377221.5430	4508827.3041	72	377061.4556	4509786.9392
13	377368.5328	4510620.2112	73	377059.1421	4509806.8696
14	377244.6495	4508745.9139	74	377056.8287	4509826.7999
15	377245.2360	4508765.9602	75	377054.5183	4509846.7306
16	377243.7160	4508785.9574	76	377052.7752	4509866.7158
17	377240.1060	4508805.6847	77	377052.2816	4509886.7706
18	377234.4461	4508824.9244	78	377053.0515	4509906.8166
19	377227.1514	4508843.6138	79	377055.0817	4509926.7744
20	377219.6086	4508862.2052	80	377058.3642	4509946.5649
21	377210.6079	4508880.1269	81	377062.8859	4509966.1095
22	377199.7765	4508897.0053	82	377068.6290	4509985.3307
23	377187.2339	4508912.6540	83	377075.5706	4510004.1522
24	377173.2080	4508926.9941	84	377083.6732	4510022.5042
25	377158.8642	4508941.0235	85	377092.3023	4510040.6180
26	377144.5204	4508955.0530	86	377100.9345	4510058.7302
27	377130.1767	4508969.0824	87	377109.5667	4510076.8425
28	377115.7516	4508983.0274	88	377118.1989	4510094.9548
29	377100.7627	4508996.3627	89	377126.8311	4510113.0671
30	377085.1784	4509008.9971	90	377135.4633	4510131.1794
31	377069.0316	4509020.9043	91	377144.0955	4510149.2917
32	377053.1588	4509033.1733	92	377152.7277	4510167.4040
33	377038.7174	4509047.0868	93	377161.3599	4510185.5163
34	377025.2595	4509061.9572	94	377169.9921	4510203.6285
35	377013.3636	4509078.1039	95	377178.6244	4510221.7408
36	377003.1580	4509095.3686	96	377187.2566	4510239.8531
37	376994.7467	4509113.5751	97	377195.8888	4510257.9654
38	376988.2157	4509132.5376	98	377204.5210	4510276.0777
39	376983.6317	4509152.0623	99	377213.1532	4510294.1900
40	376981.0415	4509171.9499	100	377221.7854	4510312.3023
41	376980.4714	4509191.9974	101	377230.4176	4510330.4146
42	376981.9274	4509212.0001	102	377239.0498	4510348.5268
43	376985.3946	4509231.7537	103	377247.6820	4510366.6391
44	376990.8375	4509251.0566	104	377256.3142	4510384.7514
45	376998.2006	4509269.7117	105	377264.9464	4510402.8637
46	377007.3408	4509287.5662	106	377273.5786	4510420.9760
47	377017.1169	4509305.0876	107	377282.2108	4510439.0883
48	377026.8958	4509322.6074	108	377290.8430	4510457.2006



49	377036.6746	4509340.1272	109	377299.4752	4510475.3129
50	377046.4535	4509357.6470	110	377308.1074	4510493.4251
51	377056.2323	4509375.1668	111	377316.7396	4510511.5374
52	377066.0112	4509392.6866	112	377325.3718	4510529.6497
53	377075.4162	4509410.4057	113	377334.0040	4510547.7620
54	377083.1199	4509428.9221	114	377342.6362	4510565.8743
55	377088.8467	4509448.1420	115	377351.2684	4510583.9866
56	377092.5339	4509467.8551	116	377359.9006	4510602.0989
57	377094.1413	4509487.8456	117	377242.3587	4508725.9824
58	377093.6511	4509507.8946	118	377365.6429	4510621.5885
59	377091.5303	4509527.8450	119	377231.0093	4508727.3760
60	377089.2169	4509547.7753	120	377233.2943	4508747.2406

			121	377233.7888	4508767.2211
--	--	--	-----	-------------	--------------

<b>Numb</b>	<b>X Gauss 4N</b>	<b>Y Gauss 4N</b>	<b>Numb</b>	<b>X Gauss 4N</b>	<b>Y Gauss 4N</b>
122	377232.0461	4508787.1317	185	377052.3978	4509930.7106
123	377228.0882	4508806.7225	186	377055.8783	4509950.3992
124	377221.9645	4508825.7479	187	377060.5751	4509969.8337
125	377214.5535	4508844.3210	188	377066.4699	4509988.9388
126	377206.8017	4508862.7498	189	377073.5400	4510007.6409
127	377197.2281	4508880.2943	190	377081.7324	4510025.8800
128	377185.7528	4508896.6585	191	377090.3355	4510043.9319
129	377172.5198	4508911.6369	192	377098.9388	4510061.9837
130	377158.2418	4508925.6375	193	377107.5422	4510080.0354
131	377143.9459	4508939.6201	194	377116.1455	4510098.0872
132	377129.6501	4508953.6026	195	377124.7489	4510116.1390
133	377115.3542	4508967.5852	196	377133.3522	4510134.1907
134	377101.0583	4508981.5678	197	377141.9556	4510152.2425
135	377086.7625	4508995.5503	198	377150.5590	4510170.2943
136	377072.4666	4509009.5329	199	377159.1623	4510188.3460
137	377058.1707	4509023.5155	200	377167.7657	4510206.3978
138	377043.8749	4509037.4981	201	377176.3690	4510224.4496
139	377029.8486	4509051.7467	202	377184.9724	4510242.5013
140	377017.1319	4509067.1688	203	377193.5757	4510260.5531
141	377006.0043	4509083.7740	204	377202.1791	4510278.6049
142	376996.5750	4509101.3991	205	377210.7825	4510296.6566
143	376988.9368	4509119.8711	206	377219.3858	4510314.7084
144	376983.1646	4509139.0085	207	377227.9892	4510332.7602
145	376979.3152	4509158.6232	208	377236.5925	4510350.8119
146	376977.4263	4509178.5227	209	377245.1959	4510368.8637
147	376977.5165	4509198.5114	210	377253.7992	4510386.9155
148	376979.5850	4509218.3930	211	377262.4026	4510404.9672
149	376983.6113	4509237.9722	212	377271.0060	4510423.0190
150	376989.5560	4509257.0567	213	377279.6093	4510441.0708
151	376997.3607	4509275.4590	214	377288.2127	4510459.1226
152	377006.7622	4509293.1045	215	377296.8160	4510477.1743
153	377016.5084	4509310.5658	216	377305.4194	4510495.2261
154	377026.2546	4509328.0271	217	377314.0227	4510513.2779
155	377036.0008	4509345.4883	218	377322.6261	4510531.3296
156	377045.7470	4509362.9496	219	377331.2294	4510549.3814
157	377055.4932	4509380.4109	220	377339.8328	4510567.4332

158	377065.2370	4509397.8735	221	377348.4362	4510585.4849
159	377074.3354	4509415.6736	222	377357.0395	4510603.5367
160	377081.5785	4509434.3028			
161	377086.8080	4509453.5943			
162	377089.9652	4509473.3310			
163	377091.0146	4509493.2912			
164	377089.9556	4509513.2514			
165	377087.6952	4509533.1201			
166	377085.3895	4509552.9839			
167	377083.0838	4509572.8476			
168	377080.7781	4509592.7113			
169	377078.4724	4509612.5751			
170	377076.1667	4509632.4388			
171	377073.8609	4509652.3025			
172	377071.5552	4509672.1662			
173	377069.2495	4509692.0300			
174	377066.9438	4509711.8937			
175	377064.6381	4509731.7574			
176	377062.3324	4509751.6212			
177	377060.0267	4509771.4849			
178	377057.7209	4509791.3486			
179	377055.4152	4509811.2123			
180	377053.1095	4509831.0761			
181	377050.8354	4509850.9434			
182	377049.3643	4509870.8831			
183	377049.1345	4509890.8756			
184	377050.1470	4509910.8438			

## Aneksi 2: Foto nga vendi i projektit dhe zona përreth



Zona përreth vendit të projektit



Depozitat e naftës të Bankers dhe zona industriale



Linja hekurudhore

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Baza e Furnizimit Durrës



Linja hekurudhore që lidhet me stacionin e ngarkimit



Ndërtime informale pranë zonës së projektit

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Baza e Furnizimit Durrës



Instalimet e vjetra të transportit të naftës në ish stacionin e ngarkimit të naftës



Pamje nga zona e projektit (stacioni dhe linja hekurudhore)

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Baza e Furnizimit Durrës



Strukturat e braktisura të ish stacionit të ngarkimit të naftës



Ndërtesë e braktisur pranë zonës së projektit

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Baza e Furnizimit Durrës



Plantacion me ullinj në zonën përreth objektit





**DIJE Lokale, Standarde Globale**

Rr. Themistokli Gërmenji  
Pranë RTVSH, IshDigitalb  
Tirana/Shqipëri

email: [info@abkons.com](mailto:info@abkons.com)  
Tel: +355 4 22 58 326  
Fax: +355 4 22 58 326  
Web: [www.abkons.com](http://www.abkons.com)

Kompania: ABKONS

Titulli i

Dokumentit: Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, Baza e Furnizimit Durrës